




Komuna Rahovec

Opština Orahovac/Municipality of Rahovec

Drejtoria për Financë dhe Buxhet

Odeljenje za Finansije i Budzet/Department of Finance and Budget



Datë/Datum/Date:	29.06.2022
Për/Za/To:	Z. Salvador Elmazi: Drejtori i Departamentit të Buxhetit
Përmes/Preko/Through:	z.Smajl Latifi: Kryetar i Komunës
Nga/Od/From:	z. Afrim Limani: Zyrtar Kryesor Financiar
Subjekti/Predmet/Subject:	Arsyetimi

Të nderuar,

Me anë të kësaj shkresë po ju dërgojmë arsyetimin e kërkuar nga ana juaj për këto projekte të cekura më poshtë:

1. Ndërtimi rrugëve Rahovec-Xerxe-Opterushë-Krushë Madhe-Gexhe-Kramovik-Hoqë, kodi 53790 në vlerë prej 70,000.00€

- Arsyetim:** në këtë projekt edhe pse kemi ndarje buxhetore për vitin 2023 janë të alokuar shuma prej 350,000.00 euro, dhe nuk e mbulon kontratën në tërësi, sepse ky projekt përfundon në fund të vitit 2024 afati i kontratës 36 mujore (2021-2024), ku planifikimi për vitin 2023 ka qenë në vlerë prej 350,000.00 euro dhe kemi shpenzuar buxhetin në shumë prej 136,608.13 euro, para dergeses për bartje. Andaj me këtë bartje na mbetet që gjysma tjetër të përfundoj në vitin 2024.

2. Ndërtimi rregullimi kanalizimeve fekale (Gropa Septike) Krushe e Madhe, Dejne, Ratkoc, Dobidol, Radoste, Rahovec, Xerxe, Gexhe, kodi 53866, në vlerë prej 50,000 €)

- Arsyetim:** Ky projekt është vazhdim i ndërtimeve të kanalizimeve fekale, e cila një lidhet me planin për zhvillim lokal komunal.

3. Ndërt. i kan. për ujëra atmos. dhe ndërt. i rrugëve me kubëza në fshatin Zatriq, kodi 48181 në shumë prej 7,200.00€

- Arsyetim:** në këtë projekt kemi mbetje të kontratës në vlerë prej 7,200.00 euro. Ku të bashkangjitur gjeni edhe kartelen e pagesave. Andaj synojm ta shlyejmë borgjin ndaj operatorit ekonomik, në mënyrë që mos të jemi subjekt i ndonjë padie gjyqësore ose ekzekutimit nga ana e thesarit.

KOMUNA E RAHOVECIT



4. Rregullimi shtreterve lumenjve prrockave Krushe Madhe, Polluzhë, Radoste, Dejnë Celin, Sapniq, kodi 53800, në vlerë prej 1000,000.00 €

- **Arsyetim:** Në këtë projekt janë realizuar afër 20% të pagesave, për arsye se operatorët ekonomik kanë heziturar të kryejnë punimet për shkak të inflacionit. Me hyrje në fuqi për përkrahjen e punëve publike synojmë që punët që nuk janë te realizuara sipas parashikimeve të realizojmë me këto mjete të bartje, në menyrë që mos ta na shkaktohen kosto shtesë nëse shkëputet projekti për shkak të inflacionit, dhe kjo është arsye kryesore që synojmë të bartim këto mjete në këtë projekt.

5. Rregullimi varrezave Dëshmorëve dhe Civileve Celinë-Krushë Madhe, Opterushe, Ratkoc-Mrasor, Rahovec kodi **53858**, në vlerë prej 20,000.00 €,

- **Arsyetim:** me bartjen e mjeteve në këtë kontratë synojmë që kontrata kornizë të përmbushet në bazë të planit dinamik dhe mos të kemi vonesa në ekzekutimin e punëve dhe në aspektin financiar.

6. Ndërtimi i Muzeut në Krushë të Madhe, kodi **50753**, në vlerë prej 25,000.00 €,

- **Arsyetim:** me këto mjete janë paraparë edhe fillimi i ndërtimit i shtëpisë Muze Sylejman Krasniqi, andaj me bartjen e këtyre mjeteve realizohet synimi.

7. Ndërtimi dhe rregullimi i Shtëpisë së kulturës Celinë (projekt i ri), në vlerë prej **35,000.00€**

- **Arsyetim:** Ky projekt është i ri dhe nuk është futur në ligjin e buxhetit të vitit 2023 për arsye se kërkesa e banorëve ka ardhur pas aprovimit të buxhetit në asamblenë komunale, dhe po ashtu pas aprovimit të ligjit për ndarje buxhetore nga Kuvendi i Kosovës.

8. Ndërtimi i qerdhes në Ratkoc, kodi **45787** në vlerë prej **1,600.00€**

- **Arsyetim:** Me këtë pagesë përmbillet i tërë projekti i ndërtimit të qerdhes në Ratkoc.

9. Ndërtimi i shkollës fillore në Fortesë, kodi **48090** në vlerë prej **45,000.00€**;

- **Arsyetim:** Me këtë pagesë përmbillet i tërë projekti i ndërtimit të shkollës në Fortesë.

10. Renovimet në shkollat Rahovec, Qifllak, Zoqishtë, kodi **53783** në vlerë prej **30,189.22€**

- **Arsyetim:** është paraparë në kuadër të drejtorisë së Arsimit për arsye se është paraqit nevoja për renovimin në këto shkolla, andaj mendojmë që më shumë e ndarë ja arrijmë qëllimin e paraparë.

Ju faleminderit